



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

Cnr.865/10

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN në përbërje nga gjyqtari Shaban Shala, me bashkëpunëtorin profesional Malsor Kryeziu, në çështjen juridike të paditësit A [REDACTED] D [REDACTED], nga Prizreni, rr. [REDACTED] [REDACTED], nr. [REDACTED], kundër të paditurës PTK "Vala", rr."Dardania", p.n, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson i autorizuari N [REDACTED] R [REDACTED], lidhur me kontestit e kthimit të numrit, pas mbajtjes së seancës kryesore dhe publike, në prezencë të palëve, me datën 03.12.2013, mori këtë:


A K T G J Y K I M

REFUZOHET SI E PA BAZUAR kërkesëpadia e paditësit A [REDACTED] D [REDACTED] nga Prizreni, me të cilën ka kërkuar që të obligohet e paditura PTK "Vala", rr."Dardania", p.n, me seli në Prishtinë që ti kthej sim kartelën paditësit me nr. 044-179-677.

Me shpenzimet procedurale obligohet paditësi.

A r s y e t i m


Paditësi në këtë gjykatë ka paraqitur padi me të cilën ka kërkuar që të obligohet e paditura PTK "Vala", rr."Dardania", p.n, me seli në Prishtinë që ti kthej sim kartelën paditësit me nr. [REDACTED]. Paditësi në seancat e mbajtura ka mbetur pranë padisë dhe kërkesë padisë, ndërsa në seancën kryesore të datës 03.12.2013 në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar: jam posedues i sim kartelës prej vitit 2000 të cilin e kam blerë në PTK "Vala" dhe se në atë kohë nuk është bërë asnjë marrëveshje në mes të shfrytëzuesve të numrave dhe PTK "vala" të cilën e vërteton sot edhe e paditura me deklaratën e saj se në atëherë nuk kanë mbajtur asnjë evidencë dhe nuk ka lidhur marrëveshje për shfrytëzim të numrit, prandaj si dëshmi të vetme ka qenë vetëm kartela e vogël dhe e madhe për vërtetimin e pronësisë së numrit. Tek pas vitit 2011 PTK "Vala" ka obliguar poseduesit e kartelave që të identifikohen dhe lidhin kontratë për shfrytëzimin e numrit, në mënyrë që të parandalohet keqpërdorimi i numrit. Sa i përket provave të propozuara nga e paditura në asnjërin prej tyre nuk dëshmohet se pala e tretë posedon dokument me të cilën ka blerë numrin ose ka kontratë me PTK "Vala", si



dhe me asnjë dokument nuk dëshmohet se pala e tretë ma ka dhënë në shfrytëzim numrin e lartcekur, prandaj kërkoj nga gjykata që të rikonfirmoj aktgjykimin e dt.09.03.2010 të kësaj gjykate me të cilin e paditura obligohet të kthej numrin 044-179-677, si dhe ti bartë shpenzimet, mirëpo nuk i ka specifikuar ato.

I autorizuari i të paditurës në përgjigjen e dhënë në padi, dhe në shqyrtimet e mbajtura e ka kundërshtuar kërkesë padinë si të pabazuar, ndërsa në seancën kryesore të datës 03.12.2013 ka deklaruar: se e kundërshton në tersi kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, dhe në këtë rast konsiderojmë se ky kontest është dashur të zhvillohet në mes të paditësit dhe Kompanisë "Oxford Studio", për faktin se paditësi ka qenë i punësuar në këtë kompani dhe ky numër kontestues ka qenë ndërmjet këtyre dy palëve. PTK ka vlerësuar kërkesën e paditësit për kthimin e numrit mirëpo nuk ka gjetur asnjë bazë ose fakt për tia kthyer këtë numër pasi që i njëjti nuk ka pasur faturë për blerjen e këtij numri, ndërsa Kompania ku paditësi ka punuar me kërkesën e dt.08.01.2010, ka kërkuar që ky numër të lidhet me kontratë mujore në emrin e kompanisë për faktin se ky numër ka qenë në pronësi të paditësit që i është ndarë nga kompania me themelimin e marrëdhënies së punës, gjithashtu kjo kompania me ankesën e paraqitur me dt.12.01.2010 ka dëshmuar se ky numër është pronë e kësaj kompanie sikurse edhe disa numra tjerë që ka në shfrytëzim dhe se korrespondon me numrin [REDACTED] për të cilin e ka vërtetuar se ky numër është blerë po nga kjo kompani.

Po ashtu në fjalën përfundimtare i autorizuari i të paditurës ka deklaruar se e konsiderojmë kërkesëpadinë si të pabazuar për faktin se pretendimet e paditësit se në kohën kur është blerë numri nuk është lidhur asnjë marrëveshje apo kontratë nuk qëndrojnë me arsye se edhe sot e kësaj dite për blerjen e numrave të telefonit nuk lidhet kontratë, për arsye se është një produkt i thjesht, mirëpo vetëm identifikohet në emër të kujt është blerë. Vlen të theksohet se paditësi ka mundur të kërkoj faturë me rastin e blerjes së numrit dhe këtë gjë nuk ka mundur të i mohoj askush. Në atë kohë PTK për shkak të fluksit të madhe të qytetarëve për blerjen e numrave, faturat i ka lëshuar vetëm me kërkesën e palës. Kjo vërteton faktin se paditësi nuk është pronar i atij numri duke marrë parasysh edhe përgjigjen e paditësit në pyetjen e gjykatës, ku deklaroi se nuk e di se ku e ka blerë atë numër. Një fakt tjetër shumë me rëndësi është se me ankesën e ushtruar nga Kompania "Oxford Studio" shihet se kjo kompani është pronare edhe e numrit [REDACTED], ndërsa pretendimet e paditësit janë për numrin [REDACTED] që vërehet se këta dy numra janë njëri pas tjetrit, dhe se i takojnë kësaj kompanie, meqenëse dy numra njëri pas tjetrit me radhë ose më shumë i janë dhënë vetëm personave juridike, ku paditësi në momentin e blerjes së këtij numri është dashur të jetë me përfaqësuesin e personit juridik. PTK ka vlerësuar arsyeshmërinë e kërkesave dhe ka vendosur që këtë numër të lidhet me kompaninë "Oxford studio", për faktin se paditësi nuk ka ofruar asnjë provë të vetme. Andaj kërkojmë nga




gjykata refuzimin e kësaj kërkesëpadie. Shpenzimet e procedurës i kërkon, por nuk i ka specifikuar ato.

Gjykata në shqyrtimin gjyqësor më qëllim të konstatimit të plotë dhe të drejt të gjendjes faktike ka administruar këto prova: dëgjimin e paditësit në cilësinë e palës, dëgjimin e të autorizuarit të paditurës në cilësinë e palës, shikimin e numrit kontestues [redacted] konkretisht fotokopjes së kartelës së madhe dhe kartelës së vogël, leximin e ankesës së "Oxford studio", [redacted], të dt.12.01.2010, leximin e kërkesës për transferimin e numrit kontestues nga "Oxford studio" me nr.02 12010 të dt.08.01.2010, leximin e aktvendimit të "Oxford studio" [redacted] i dt.17.10.2008, leximin e kontratës për parapagim lidhur me numrin kontestues të dt.08.01.2010, shikimin e certifikatës së regjistrimit të biznesit "Oxford studio" nr.[redacted], shikimin e numrit fiskal nr.[redacted] dhe pas vlerësimit të këtyre provave në kuptim të nenit 8 të LPK-së, ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit duke refuzuar kërkesë padinë e paditësit si të pa bazuar pasi ka vërtetuar gjendjen faktike si më poshtë:

Nga dëgjimi i paditësit në cilësinë e palës, i autorizuari i të paditurës në cilësinë e palës, nuk është kontestues fakti se paditësi ka qenë posedues i numrit kontestues që nga viti 2000 e deri më dt.08.01.2010, kur i është marrë paditësit numri nga PTK "VALA" dhe i është dhënë palës së tretë "Oxford studio". Pala paditëse ka qenë në marrëdhënie pune në "Oxford studio" deri në janar 2010 dhe se me ndërprerjen e marrëdhënies së punës në këtë kompani, kjo e fundit kërkon nga PTK "VALA" që të i kthehet numri asaj në posedim pasi që është edhe pronare e këtij numri. Numri kontestues i është dhënë në shfrytëzim paditësit nga ana e kompanisë "Oxford studio" deri sa ka qenë në marrëdhënie pune, mirëpo me shkëputjen e bashkëpunimit kjo kompani ka kërkuar që numri kontestues të jetë në shfrytëzim të zhvillimit të biznesit të kësaj kompanie.

Nga leximi i ankesës së "Oxford studio", nr.[redacted], të dt.12.01.2010 kompania "Oxford studio", i është drejtuar Operatorit Vala me ankesë, me të cilën e informon se "Oxford studio", përfaqësuesja e saj ka blerë numrat e telefonit në mesin e tyre edhe numri kontestues [redacted], i cili numër i është dhënë në shfrytëzim bashkëpunëtorit z. A [redacted] D [redacted], mirëpo që nga janari kanë shkëputur bashkëpunimin dhe e lusin sektorin për konsumator që ti mundësohet që ky numër të vazhdojë të jetë numër në zhvillimin e biznesit tonë për shkak që të mos vjen deri te keqpërdorimi i numrit.

Nga leximi i kërkesës për transferimin e numrit kontestues nga "Oxford studio" me nr.[redacted] të dt.08.01.2010 "Oxford studio", ka kërkuar që numri kontestues [redacted] të transferohet në emër të biznesit Q.P.A.P, "Oxford studio" dhe ky numër të kyçet në pakon extra roaming.




Nga leximi i aktvendimit të "Oxford studio" [redacted] i dt.17.10.2008, gjykata ka konstatuar se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune në "Oxford studio" dhe është emëruar në cilësinë e Menaxherit të degës në Prizren.

Nga leximi i kontratës për parapagim lidhur me numrin kontestues të dt.08.01.2010, u konstatua se nga Shërbimi i parapagimit "VALA", "Oxford studio" ka zgjedhur për numrin e telefonit kontestues këto shërbime: Pakon VALA EXTRA-500 min +180sms, roming, fatura e detajizuar dhe regjistrimi në regjistrin telefonik, kjo kontratë duhet të jetë valide së paku 6 muaj.

Gjykata po ashtu ka bërë shikimin e certifikatës së regjistrimit të biznesit "Oxford studio" nr. [redacted] dhe shikimi e numrit fiskal nr. [redacted], dhe ka konstatuar se "Oxford studio", është i regjistruar si biznes individual dhe vepron në disa qendra të Kosovës në mesin e të cilave edhe në Prizren.

Nga administrimi i provave të lartcekura, gjykata ka konstatuar gjendjen faktike sipas së cilës pala paditëse ka qenë në posedim të numrit kontestues [redacted], prej vitit 2000 e deri në vitin 2010, ku nga ana e të paditurit i është marrë numri i sim kartelës dhe i është dhënë palës së tretë "Oxford studio" pas kërkesës që kjo e fundit i është drejtuar të paditurës që numri kontestues të transferohet në emër të biznesit Q.P.A.P "Oxford studio" dhe që numri të kyqet në pakon Vala EXTRA dhe roming si dhe pas ankesës të cilën pala e tretë "Oxford studio", i ka bërë të paditurës me të cilën shpjegon se në janar 2000 kjo kompani ka blerë disa numra të telefonit, në mesin e të cilave edhe numrin kontestues dhe se ky numër nga kjo kompani i është dhënë në shfrytëzim bashkëpunëtorit Z. A. [redacted] D. [redacted], (menaxher në njësinë nr.4 në Prizren), mirëpo nga janari 2010 kanë shkëputur bashkëpunimin me këtë të fundit dhe nga VALA-sektori për konsumator kanë kërkuar që ky numër të vazhdojë të jetë numër i këtij biznesi. Vala e ka aprovuar kërkesën e "Oxford studio", respektivisht z. A. [redacted] Sh. [redacted] Menaxher i sigurimit të hyrave Vala PTK. Po ashtu nga vetë deklarata e paditësit se nuk e mbanë mend se ku në cilën pikë të shitjes e ka blerë numrin kontestues gjykata ka konstatuar se ky numër kontestues nuk është blerë nga paditësi duke marrë parasysh se nuk posedon asnjë dokumentacion (faturë) dhe se nuk e dinë se ku e ka blerë numrin në cilën pikë të shitjes. Të vetmet prova që i ka është kartela e madhe dhe e vogël e numrit të cilat nuk vërtetojnë pronësinë e numrit. Po ashtu duke marrë parasysh se dy numra sipas radhitjes së njëpasnjëshme, këta numra i janë ndarë vetëm personave juridik gjë që korrespondon me atë se numrin e njëpasnjëshëm e posedon po e njëjta kompani "Oxford studio" u konstatua se ky numër kontestues është pronë e kësaj të fundit.

Duke u bazuar në këtë gjendje të vërtetuar faktike gjykata e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke u bazuar në nenin 7 dhe 319 LPK-së, për shkak se paditësi nuk i ka provuar pretendimet e




veta konkretisht nuk ka vërtetuar pronësinë lidhur me numrin e telefonit kontestues.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë në bazë të nenit 452.1 të LPK.


Nga arsyerat e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Cnr.865/10, të dt.03.12.2013

Bashkëpunëtori profesional,
Malsor Kryeziu



Gjyqtari
Shaban Shala



UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur mund të ushtrojë ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditë nga dita e pranimit, ankesa dorëzohet nëpërmjet të kësaj gjykate.